

**FRYMA IDEOLOGJIKE DHE KARAKTERI  
KOMBËTAR NË ART GJATË REALIZIMIT  
SOCIALIST TË VITEVE '70**



**Arti pamor**

**Fjalë kyçe:** skulpturë, arti socialist,  
Enver Hoxha, kultura kombëtare.

**Ardian Isufi**

**Abstract**

Skulptura jonë e realizimit socialist përshkohet fund e krye nga ndjenja e optimizmit revolucionar. Ajo u flet njerëzve për bukurinë e jetës, për madhësinë e popullit e të revolucionit, për të ardhmen e ndritur të Atdheut e të njerëzimit, duke i frymëzuar ata me ndjenjën e perspektivës dhe me idenë e luftës e të përpjekjeve për arritjen e fitoreve të reja. Forcimi dhe konsolidimi i tipareve që janë më të qenësishme për natyrën dhe rolin e artit socialist në jetën e shoqërisë sonë, do ta ngrinte në një shkallë më të lartë partishmërinë proletare. Për artin tonë socialist është karakteristikë dalluese fakti se ai përshkohet tejmbanë nga idealet e socializmit, frymëzohet nga përpjekjet e masave dhe, nga ana e tij. I frymëzohen ato me këto ideale. Vetëm një art i madh që ka dalë nga gjiri i popullit e që është vënë në shërbim të revolucionit, që udhëhiqet dhe orientohet nga një parti marksiste-leniniste, mund të mishërojë idealet e mëdha shoqërore.<sup>1</sup> Arti ynë i realizimit socialist, -ka thënë shoku Enver Hoxha, - me idealet e tij revolucionare dhe me synimet për t'i shërbyer socializmit dhe popullit ngrihet përballë artit të çoroditur dekadent borgjez dhe revizionist.<sup>2</sup>

Vlera ideologjike e një arti varet nga karakteri i idealeve që ai bart. Nga kjo pikëpamje është fare e qartë se krijimtaria jonë artistike shquhet për vlerat e saj të mëdha ideologjike, për pasurinë dhe thellësinë e ndjenjave dhe të mendimeve që ajo u transmeton masave të gjera punonjëse. Heronjtë e veprave artistike janë, ndër të tjera, mishërimi i idealeve të shoqërisë sonë socialiste; ata tipizojnë atë që është më pozitive dhe të frymëzojnë drejt horizonteve të reja. Ku mund të përmendimin komisarin Memo apo Cucën e Maleve.

Kërkesë e domosdoshme e partishmërisë proletare është udhëheqja e Partisë së klasës punëtore, në fushën e letërsisë dhe të arteve. Falë kësaj udhëheqjeje letërsia dhe artet tona kanë ecur në rrugë të drejtë, janë vënë në shërbim të revolucionit socialist, kanë arritur një shkallë të lartë zhvillimi dhe janë bërë të dashura për masat e të domosdoshme për jetën shpirtërore të tyre.

Në konceptin e realizimit socialist gjatë gjithë historisë së saj Partia është kujdesur që letërsia dhe artet të zhvillohen në rrugë të drejtë, që ato të zënë një vend të rëndësishëm e të luajnë rol të madh e të veçantë në edukimin e njeriut tonë të ri. Dokumentet e Partisë dhe fjalimet udhëheqës të asaj kohe, të shprehur me termin “shoku Enver Hoxha”, për letërsinë dhe artet trajtoheshin sipas parimeve marksiste-leniniste, të vendosura në një varg problemesh praktike dhe teorike të artit. Këto parime të realizimit socialist në këto periudhë kanë shërbyer si platformë pune dhe në të njëjtën kohë kanë luajtur një rol të madh frymëzues dhe krijues të të gjitha aspektet e artit shqiptar dhe jo vetëm

<sup>1</sup> Tefik Çausi, *Dukuri estetike në art*, Naim Frashëri, Tiranë, 1984, f. 15-16.

<sup>2</sup> Enver Hoxh, *Raport në Kongresin VII në PPSH*, Tiranë, 1976, f. 176.

Nga komunistët,-thotë shoku Enver Hoxha,-mund të mos kërkohet të dinë me hollësi anët teknike dhe artistike, por mbrojtja e vijës është detyrë themelore e tyre. Për vijën e Partisë specialist mund të jetë çdo komunist.<sup>3</sup>

Drejtim me rëndësi i udhëheqjes së Partisë ja qenë dhe është puna për edukimin dhe kalitjen revolucionare të artistëve, për të formuar te këta botëkuptim të plotë marksist-leninist dhe karakteristika të një revolucionari të vërtetë. Puna e madhe që ka bërë Partia ja dhënë si fryt një armatë të tërë krijuesish të lidhur ngushtë me popullin, të bashkuar rreth Partisë dhe të gatshëm t’i shërbejnë atdheut dhe gjithçkaje për mbrojtjen e parimeve socialiste.

Vija e Partisë për problemet e artit është përgjithësim i praktikës artistike i mbështetur në estetikën marksiste-leniniste. Në këtë mënyrë kjo është vija e vetë artistëve dhe shkrimtarëve. Por udhëheqja e Partisë nuk është diçka që vendoset një herë e përgjithmonë.

“Sa më tepër revolucioni shkon përpara e thellohet,-ka thënë shoku Enver Hoxha,-aq më tepër roli udhëheqës i Partisë duhet forcuar e përsosur në çdo sferë të jetës e të veprimtarisë shtetërore e shoqërore”.<sup>4</sup>

Në vitet 70 forcimi i karakterit kombëtar është, ndër të tjera, një vlerë e madhe në luftën kundër ndikimeve të kulturës dhe të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Karakteri kombëtar i artit, nga njëra anë dhe ndikimet e huaja borgjeze e revizioniste, nga ana tjetër, janë dy forca që tërheqin në skaje të kundërta.

Në pasqyrimin e realitetit socialist edhe karakteri kombëtar fiton tipare të reja cilësore, zhvillohet e ngrihet në një shkallë të re më të lartë.

Veç karakterit historik, gjatë periudhës së realizmit socialist në këto vitet ’70, vuri në dukje karakterin klasor të artit dhe të kulturës kombëtare, si një tipar i qenësishëm i saj. Ky karakter klasor bën që, në vartësi të klasave që ekzistojnë, qoftë edhe të pazhvilluara, elemente të kulturës demokratike dhe socialiste, sepse në çdo komb ka një masë punonjëse dhe të shfrytëzuat, kushtet e jetës të së cilës lindin në mënyrë të pashmangshme ideologjinë demokratike dhe socialiste. Por në çdo komb ekziston gjithashtu edhe kultura borgjeze (dhe në shumicën e kombeve ekziston dhe një kulturë ultrareaksionare dhe klerikale) dhe jo vetëm në trajtën e “elementeve”, por si kulturës sunduese.<sup>5</sup>

Karakterit kombëtar i artit socialist është një cilësi që lind së bashku me krijimin e veprës. Ai nuk është diçka që bashkëngjitet apo që induktohet nga jashtë, nuk është një “përkapje” e veprës me disa ngjyra kombëtare.

Karakterit kombëtar i artit konsiston në pasqyrimin e tërësisë shpirtërore të një kombi, të pikëpamjeve dhe të botëkuptimit për çështjet më jetike të tij, të psikologjisë dhe të ndërgjegjes

<sup>3</sup> Enver Hoxha, Raporte e fjalime, 1972-1973, f. 326.

<sup>4</sup> Enver Hoxha, Raport në Kongresin VII të PPSH, Tiranë, 1976, f. 26.

<sup>5</sup> Lenini për kulturën dhe artin, Tiranë, 1970, f. 57.

popullore, të veprimtarisë së tij shoqërore. Në këtë periudhë kohore karakteri kombëtar përcaktohej në radhë të parë, nga konceptet që ka populli për jetën dhe për vdekjen, për lirinë, sakrificat, ligjit, për mikun dhe armikun, nga ndjenja e humorit, fatalizmit ose groteskut, nga raporti midis epikës dhe lirikës, optimistes dhe pesimistes, indiferencës dhe angazhimit, nga forca dhe mënyra e veprimtarisë shoqërore etj.<sup>6</sup>

Karakterit kombëtar dhe fryma popullore realizohen duke pasqyruar me vërtetësi realitetin, nga pozitat e ideologjinë marksiste-leniniste, duke asimiluar në mënyrë kritike de nga pozita klasore gjithë përvojën e kulturës sonë, traditën e vjetër përparimtare dhe të rene revolucionare, duke u mbështetur fort në krijimtarinë e popullit.

Në raportin që mbajti Enver Hoxha, në Kongresin e 8-të të Partisë theksoi se: “Duhet të ruhet një raport i drejtë në marrëdhëniet midis artit të kultivuar dhe atij popullor, të mos abuzohet me dhënien e përparësisë njërit ndaj tjetrit, sepse ashtu siç është e dëmshme shkëputja e artit të kultivuar nga ai popullor, po ashtu është e dëmshme edhe vënia e barazisë midis tyre dhe kthimi i artit të kultivuar në një imitim të thjeshtë të artit popullor”.<sup>7</sup>

Në mendimin estetik të Partisë gjejmë edhe tezën se “karakterit kombëtar popullor shprehet jo vetëm në krijimtari, por edhe në ekzekutimin dhe interpretimin e saj.

## Literatura

- Çausi, T. (1984). *Dukuri estetike në art*, Naim Frashëri, Tiranë.  
 Hoxha, E. (1976). *Raport në Kongresin VII në PPSH*, Tiranë.  
 Hoxha, E. (1972-73). Raporte e fjalime.  
 Hoxha, E. (1976). Raport në Kongresin VII të PPSH, Tiranë.  
 Lenini për kulturën dhe artin, Tiranë, 1970.  
 Zëri i popullit, dt. 8 prill, 1973.  
 Hoxha, E. (1981). Raport në Kongresin VIII të PPSH, Tiranë.

<sup>6</sup> Zëri i popullit, dt. 8 prill, 1973.

<sup>7</sup> Enver Hoxha, Raport në Kongresin VIII të PPSH, Tiranë, 1981, f. 141.